



- Të Reja ▾ Policia e Shtetit ▾ Historik i shkurtër i Policisë së shtetit shqiptar Shërbime ▾ Baza ligjore Vendndodhjet e policisë Video
- Programi i transparencës ▾ Kontakt Denonco Krimin Kibernetik Drejtoritë Vendore të Policisë ▾ Policia Kufitare ▾ Policia Rrugore ▾
- Donacione Rubrika Policimi në Komunitet ▾ Përmbledhja Javore Për sinjalizimin

Breaking News:

Dibër – Ndërhyrja në kohë e Policisë parandaloi përshkallëzimin e një konflikti



12/04/2023

Fier – Në Kuadër Të Operacionit “Kreshpan”, Gjenden Dhe Asgjësohen 182 Fidanë Narkotikë Cannabis Sativa, Të Mbjellë Në Kubikë

Kontrolle në të gjithë territorin e qarkut, me qëllim parandalimin dhe goditjen që në fazë fillestare, të tentativave për kultivim të bimëve narkotike.

Arrestohet në flagrancë pronarja e banesës ku u gjetën fidanët narkotikë, si dhe shpallet në kërkim bashkëshorti i saj.

Në banesën e këtyre shtetasve, u gjet edhe një armë gjahu që mbahej pa leje.

Shërbimet e Komisarariatit të Policisë Fier, në zbatim të detyrave të marra në kuadër të planit operacional mbarëkombëtar, me fokus parandalimin e kultivimit të bimëve narkotike dhe goditjen e kësaj veprimtarie kriminale, që në fazë fillestare, si dhe me mbështetjen e inteligjencës informative, kanë evidentuar dhe kanë goditur në kuadër të operacionit policor të koduar “Kreshpan”, një tjetër rast të kësaj veprimtarie kriminale, për të cilin u arrestua në flagrancë shtetasja P. Y., 49 vjeçe, si dhe u shpall në kërkim bashkëshorti i saj shtetasi D. Y., 51 vjeç (alias S. Y., alias K. Y.).

Si rezultat i kontrolleve, në banesën e këtyre shtetasve, në fshatin Kreshpan, shërbimet e Policisë gjetën dhe asgjësuan 182 fidanë të dyshuar narkotikë cannabis sativa, të mbjellë në kubikë.

Gjithashtu, në banesën e këtyre shtetasve u gjet dhe u sekuestrua një armë gjahu që mbahej pa leje.

Vijon puna për kapjen dhe nxjerrjen përpara përgjegjësisë penale të shtetasit D. Y.

Materialet procedurale i kaluan Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier, për veprime të mëtejshme.

Kërko

Enter a word for search



Komisariati Dixhital

GET IT ON
Google Play

Download on the
App Store

Arkiva

Select Month ▾

Linqe

- > Arkiva
- > Akademia e Sigurisë
- > Ministria e Brendshme
- > Agjencia e Mbikëqyrjes Policore
- > Interpol
- > Europol
- > Misioni PAMECA V
- > SCPA
- > Projekti Trivalent

◀ Policia e Shtetit – Kapet dhe vihet në pranga një shtetas i akuzuar për nxitje, thirrje publike dhe propagandë për kryerjen e veprave me qëllime terroriste

Dibër – Ndërhyrja në kohë e Policisë parandaloi përshkallëzimin e një konflikti ▶